# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-468911**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Si rrallëherë këtë vit, Euro e mbyll javën në rritje |
| ADRESA | `https://lajmifundit.al/si-rrallehere-kete-vit-euro-e-mbyll-javen-ne-rritje-i1338684` |
| BURIMI | lajmifundit.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 13:02:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 14:54:06 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6372616173a0b95892dfe9237bcb2e4d534167a88c336abf5ff0b3a45256384c` |
| TEKSTI | `5e1f02d0a73a104d3e1931b8c912d32873e8003229649885cfce5ae6a6392bac` |
| PAMJA | `338cd129829810882fc83dc3d51190b9607b5525a353ffcfee6ad8475ea1388d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `84620d0b04a050a6061eb697322edf31e970ef52802ff607e14cce7e10ebd9a0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7ef11613d0a46fe814f564609ee7439753917635a3984a70b661e478103337ad` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/84620d0b04a050a6061eb697322edf31e970ef52802ff607e14cce7e10ebd9a0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Si rrallëherë këtë vit, Euro e mbyll javën në rritje

LAJMIFUNDIT / 25 SEPTEMBER 2026, 14:54

Shperndaje

AKTUALITET



Kursi i këmbimit të Euros me Lekun e ka mbyllur javën në rritje. Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, Euro u këmbye të premten me 91.97 lekë, duke fituar afërsisht 0.5 lekë krahasuar me të enjten. Ky është niveli më i lartë i kursit të këmbimit Euro-Lek në dy javët e fundit.

Sipas agjentëve të tregut, rritja e forta afatshkurtra të Euros në përgjithësi janë të lidhura me operacione të veçanta të blerjes së valutës në shuma të mëdha.

Rritja në mënyrë të papritur e kërkesës në treg zakonisht shoqërohet me një mbiçmim të shpejtë ditor të Euros.

Ky është një fenoment që është vërejtur disa herë në kursin e këmbimit gjatë viteve të fundit. Megjithatë, zakonisht kjo rritje është afatshkurtër dhe amortizohet nga tregu në harkun e pak ditëve, pikërisht sepse është e lidhur me operacione sporadike të blerjes dhe zakonisht nuk reflekton një kërkesë me bazë të gjerë.

Nga ana tjetër, një korrektim i lehtë në rritje i kursit pas përfundimit të sezonit veror mund të jetë i pritshëm. Kjo ka qenë e zakonshme në vitet e mëparshme, por zakonisht tendenca ka nisur më herët, qysh me kalimin e pikut të sezonit. Këtë vit rënia e Euros ka vijuar e pandërprerë edhe gjatë muajit shtator dhe një korrektim i lehtë nga nivelet minimale historike të shtatorit mund të pritet në vazhdim.

LEXONI GJITHASHTU

Goditet rrjeti neo-nazist në Itali, arrestohen 14 adoleshentë dhe 3 të rritur, ja çfarë ndodhi

MOTI NE TIRANE
Tirana, Albania

POLITIKË
Edi Rama merr fjalën sot në OKB, çfarë do të thotë kryeministri përballë udhëheqësve të botës?

POLITIKË
Përplasja për Vlora Hysenin, Koçeku: Për kryeministrin katundi vend thashethemesh, për mua vendi ku mbahet fjala

TRENDING
8,500 dëshmi konkrete të mbështetjes financiare nga sigurimi shëndetësor në SIGAL
One Albania sjell inovacionin Wi-Fi 7 për internetin në shtëpi


**Zjarr në banesën në Sarandë, dy të moshuarit dërgohen në spital**



**U komandua në krye të SHISH para dy ditësh, Elvis Lila do merret në pyetje nga SPAK, dyshohet se janë fshirë serverët**

Edhe gjatë vitit 2026 Euro ka vijuar tendencën afatgjatë rënëse në kursin e këmbimit me Lekun, madje me ritme edhe më të shpejta krahasuar me vitin e kaluar. Rënia vjetore e kursit këtë muaj ka arritur pranë nivelit maksimal vjetor prej 6%.

Statistikat e Bankës së Shqipërisë treguan një përmirësim të ndjeshëm të Bilancit të Pagesave edhe në gjysmën e parë të këtij viti. Për 6-mujorin 2026, deficiti i llogarisë korrente pësoi rënie, me një vlerë totale prej 361 milionë eurosh ose 40.6% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Deficiti i llogarisë korrente për 6-mujorin ka shënuar njëkohësisht nivelin më të ulët që prej vitit 2018. Ulja e deficitit ka ardhur kryesisht nga rritja e eksporteve të shërbimeve dhe nga remitancat.

Efekt shtesë në bilancin e përgjithshëm duket të ketë dhënë edhe rritja e fortë e investimeve të huaja direkte. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se për tremujorin e dytë 2026 vlera e investimeve të huaja direkte arriti në 741 milionë euro, në rritje me 86% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Kjo rritje u ndikua ndjeshëm nga flukse të lidhura me një projekt të rëndësishëm zhvillimi në sektorin e pasurive të paluajtshme. Për të gjithë 6-mujorin e parë, vlera e përgjithshme e investimeve të huaja direkte arriti në 1.144 miliardë euro, me një rritje prej 50% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjithashtu, një efekt shtesë duket se ka ushtruar edhe suficiti i bollshëm fiskal, që ka ulur ofertën e Lekut në treg. Për 8-mujorin 2026, buxheti ishte në suficit në vlerën e 61.6 miliardë lekëve, në rritje me 52% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë./Monitor/

POLITIKË

**Rama nesër në Asamblenë e Përgjithshme: Çfarë pritet të deklarojë kryeministri shqiptar përballë krerëve të botës?**

POLITIKË

**Çfarë po ndodh? Ndërpritet për herë të tretë seanca plenare pas përplasjeve në Kuvend**

## ME TE LEXUARAT

"Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...
Lexo lajmin e plote

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
Lexo lajmin e plote

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!...
Lexo lajmin e plote

## ME TE LEXUARAT

"Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e Gjovalin Lazrit

Lexo lajmin e plote

Euron pëson rënien si asnjëherë

Skandali "Xhaka" merr përmasa të

Zbulohet e vërteta për Bleona

## NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

Kliko për më shumë informacion

më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
Lexo lajmin e plote

tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
Lexo lajmin e plote

Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!
Lexo lajmin e plote

"Askush nuk është mbi ligjin"/ Rama shkarkon menjëherë Vlora Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH
Lexo lajmin e plote

Sekuestrohet hoteli "Central Park Premium" në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket
Lexo lajmin e plote

"Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot"/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap
Lexo lajmin e plote

LAJMI FUNDIT

KUSH JEMI | KONTAKT REDAKSINË | TE DHENAT PERSONALE | COOKIES

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by Mediadesk

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do te merrni njoftime periodike me Lajmet e Fundit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.